

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë) ☐

INERTI

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J66926804L

NUIS/NIPT

L. SPORTI

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0693332122

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

inerti.shpk@gmail.com

E-mail

Administrator Florjan Muha

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2025/05/29

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0695483815

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-48739-05-22-2025

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Local

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Operatori i Blerjeve të Perqendruara

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

136440283

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Rikonstruksioni i Shërbimit të Patologjisë – Spitali Vlorë

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2025/06/09

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme) ☐

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës) ☐

Tipi i kontratës

Punë

Data e zhvillimit të procedurës

2025/05/23

Numri i njoftimit

Buletini Nr. 27 date 26 Maj 2025

Kodi CPV

45210000-2

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.) ☐

Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji nr.162 dt. 23.12.2020 Për prokurimin publik i ndryshuar; Direktivës 2014/24/BE

2. Objekti i ankesës ☐

- Modifikim i dokumentave të tenderit

☒

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

☐

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/dis operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

☐

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate ☐

☐

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

☐

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Ne date 23-05-2025, autoriteti kontraktor Operatori i blerjeve të përqendruara, publikoj procedurën me objekt Rikonstruksionin e Shërbimit të Patologjisë – Spitali Vlorë. Për sa më sipër gjykojmë se kriteret e vendosura në DST për realizimin e kësaj procedure janë disproporcionale me objektin e tenderit dhe ngushtojnë konkurrencën.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

? Në dokumentat standarte të tenderit, në pikën 4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Autoriteti Kontraktor ka caktuar që Ngjashmëria e zerave të preventivave të kontratave të ngjashme me elemente të preventivit të procedurës së prokurimit punime për sistemin e gazit mjekësor do të vlerësohen [0 - 15 pikë] duke sqaruar se: Kontratat e ngjashme, të realizuara me sukses janë një kriter mjaft i rëndësishëm për të vërtetuar se një OE ka aftësi teknike, ekonomike dhe financiare për realizimin me sukses të kontratës. Zërat e preventivave të kontratave të ngjashme janë mjaft të rëndësishëm për të vlerësuar se cili OE mund ta realizojë me mirë në kohë dhe çilesi një kontratë. Zërat të ngjashëm apo të njëjtë që janë realizuar me sukses orientojnë një OE i cili e ka më të lehtë për të realizuar në të ardhmen sesa një OE që nuk i ka zbatuar ndonjëherë zërat e tillë. Për këtë arsye vlerësimi me pikë do të bëhet në mënyrë maksimale për ato OE që kanë zërat të ngjashëm të kontratave të ngjashmeme preventivin që prokurorët për punimet për sistemin e gazit mjekësor.

Për sa më sipër, në përputhje me Nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020, theksojmë që qëllimi i ligjit për prokurimin publik është ndërtuar mbi parime themelore që përbëjnë thelbin e gjithë sistemit të prokurimeve në Republikën e Shqipërisë.

Këto qëllime përfshijnë:

- ? rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në përdorimin e fondeve publike
- ? nxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë
- ? garantimin e trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues
- ? si dhe integritetin dhe transparencën në procedurë

Në këtë kontekst, vendosja në dokumentet e tenderit e një kriteri të vlerësimit me 15 pikë nga 100 të mundshme, i cili lidhet me përvojën specifike në sistemin e gazit mjekësor, përbën një devijim të qartë nga këto qëllime të ligjit, për arsye si më poshtë:

? Cenimi i parimit të konkurrencës dhe pjesëmarrjes së gjerë Ky kriter është tepër i ngushtë dhe në mënyrë të pashmangshme përjashton pjesën më të madhe të operatorëve ekonomikë nga konkurrimi efektiv në procedurë, duke lejuar në praktikë vetëm një numër shumë të vogël kompanish të grumbullojnë pikët e plota në këtë zë. Kriteri nuk bazohet në ndonjë analizë të nevojës teknike ose të rrezikut specifik të projektit, por mbështetet në një lloj formalizmi që nuk pasqyron realisht kapacitetin teknik të operatorëve për të realizuar punime të ngjashme. Në këtë mënyrë, ai kufizon pjesëmarrjen pa një justifikim të arsyeshëm, duke shkelur objektivin e ligjit për të nxitur konkurrencën.

? Shkelja e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit

Nëse vetëm disa operatorë të caktuar kanë mundur të përfshijnë më parë sistemin e gazit mjekësor në portofolin e tyre, kjo do të thotë që kriteri favorizon në mënyrë të drejtpërdrejtë një kategori të ngushtë dhe të paracaktuar ekonomikisht, duke përjashtuar të tjerët nga e drejta për një vlerësim të drejtë dhe të barabartë.

? Mungesa e proporcionalitetit midis objektit të kontratës dhe peshës së kriterit

Edhe nëse instalimi i gazit mjekësor përfshihet në objektin e kontratës, dhënia e një peshe kaq të lartë në vlerësim (15 pike) për një zë që përbën një përqindje shumë më të vogël të volumit dhe vlerës financiare të kontratës është joproporcionale dhe në kundërshtim me logjikën e vlerësimit të përgjithshëm teknik.

Parimi i proporcionalitetit, i njohur në të drejtën administrative dhe në standardet e BE-së për prokurimet (sipas Direktivës 2014/24/BE, neni 18) dhe kërkon që kriteret e vendosura të jenë të domosdoshme, të arsyeshme dhe të përshtatshme për arritjen e qëllimit të kontratës. Në mungesë të një arsytimi teknik të dokumentuar për këtë vlerësim specifik, ky kriter bie ndesh me këtë parim.

Konkretisht në nenin 18 të Direktivës 2014/24/BE citohet:

Neni 18 - Parimet e prokurimit

Autoritetet kontraktore duhet të trajtojnë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim dhe të veprojnë në mënyrë transparente dhe proporcionale.

Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, 28.3.2014, L 94/105 EN

Hartimi i procedurës së prokurimit nuk duhet të bëhet me qëllimin e përjashtimit të saj nga fusha e zbatimit të kësaj Direktive apo për të ngushtuar artificialisht konkurrencën.

Konkurrenca do të konsiderohet e ngushtuar artificialisht kur hartimi i prokurimit bëhet me qëllimin për të favorizuar padrejtësisht ose për të dëmtuar disa operatorë ekonomikë.

Shtetet anëtare duhet të marrin masa të përshtatshme për të siguruar që, gjatë zbatimit të kontratave publike, operatorët ekonomikë të respektojnë detyrimet përkatëse në fushat e të drejtës mjedisore, sociale dhe të punës, të përcaktuara nga e drejta e Bashkimit, ligji kombëtar, marrëveshjet kolektive ose nga dispozitat ndërkombëtare të të drejtës mjedisore, sociale dhe të punës të listuara në Aneksin X.

Pra Sipas parimeve të Bashkimit Evropian për prokurimin publik (Direktiva 2014/24/BE), kriteret e përzgjedhjes dhe vlerësimit duhet të jenë objektive dhe mos favorizojnë operatorë të veçantë. Përdorimi i një kriteri për përvojën në një zë kaq specifik duke përjashtuar përvoja të ngjashme, është i papajtueshëm me këto standarde dhe mund të konsiderohet si praktikë diskriminuese e ndaluar. Në një kohë që cdo ditë e më shumë ne synojmë përafrimin e legjislacionit me *acquis communautaire*, këto kritere të vendosura bien ndesh me frymën dhe standardet evropiane;

? Cënimi i mirëpërdorimit të fondeve publike (neni 2, pika b)

Kur konkurrojnë më pak operatorë, bie cilësia e konkurrencës, rritet rreziku i ofertave të fryra ose i marrëveshjeve oligopolistike, dhe fondet publike nuk përdoren në mënyrën më të favorshme për autoritetin kontraktor. Kjo bie në kundërshtim me objektivin thelbësor të ligjit për efikasitet dhe kursim.

Në një shtet të së drejtës dhe me një sistem të hapur konkurrimi, çdo kufizim duhet të jetë i arsytuar, proporcional dhe i hapur për një gamë sa më të gjerë pjesëmarrësish. Kriteri në fjalë, ashtu siç është ndërtuar, deformon konkurrencën, kushtëzon barazinë, dhe dëmton efikasitetin e prokurimit publik, duke e bërë të nevojshëm rishikimin e menjëhershëm të dokumentacionit të tenderit.

Duke vijuar arsytimin mbështetur në Ligjin e prokurimit publik, gjykojmë gjithashtu që këto

kritere janë vendosur në shkelje të Nenit 3 ku citohet:

Neni 3, Parime të përgjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Kriteri që shpërblen me 15 pikë operatorët që kanë realizuar sistem të gazit mjekësor në projekte të mëparshme, ndonëse nuk përjashton formalisht operatorët e tjerë, në praktikë krijon një pabarazi të qartë në trajtimin e tyre, pasi:

- ? Ai nuk njeh përvoja alternative që mund të jenë objektivist të barasvlershme
- ? Favorizon operatorët që kanë pasur akses të mëparshëm në projekte shumë specifike dhe të kufizuara në numër, duke i vendosur të tjerët në pozitë jo të barabartë në garë.
- ? Kjo bie ndesh me detyrimin e autoritetit për të trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë dhe për të mos ndërtuar kritere që, edhe në mënyrë të tërthortë, prodhojnë efekt diskriminues.

Vendosja e këtij kriteri përbën një ngushtim artificial të konkurrencës, në kuptimin e drejtpërdrejtë të paragrafit 2 të nenit 3 kjo pasi kriteri nuk është proporcionale me objektin e përgjithshëm të kontratës (rikonstruksion i një spitali, që përfshin shumë zëra dhe sisteme teknike të ndryshme). Sic e theksuam dhe me siper, ky kriter favorizon operatorë specifike, në praktikë shumë të kufizuara në numër, që kanë kryer më parë vetëm një komponent të projektit (gazin mjekësor), duke dëmtuar padrejtësisht operatorët e tjerë që kanë përvojë të gjerë në projekte të natyrës së ngjashme, por që nuk kanë përfshirë këtë zë specifik.

Kjo formë ndërtimi e kritereve bie ndesh me frymën e ligjit për konkurrencë të ndershme dhe të hapur, dhe ka potencialin të krijojë favorizim të tërthortë, ndonëse jo eksplicit, për subjekte të njohura paraprakisht nga autoriteti kontraktor.

Ky është një shembull tipik i shmangies së parimeve të ligjit përmes një formulimi teknik, por që prodhon efektet që ligji kërkon të ndalojë.

Nje nga parimet kryesore qe mbeshetetet dhe nga paragrafi 1 i ketij neni eshte dhe Parimi I Proporcionalitetit. Parimi i proporcionalitetit kërkon që masat e marra nga autoritetet publike:

- ? të jenë të domosdoshme,
- ? të përshtatshme për të arritur objektivat e ligjshëm,
- ? dhe të mos tejkalojnë kufijtë e arsyeshëm të asaj që kërkohet për të arritur objektivin.

Vendosja e një peshe kaq të lartë për një zë specifik në një projekt kompleks si rikonstruksioni i një spitali përbën një tejkalim të kësaj mase të arsyeshme dhe nuk është e domosdoshme për të garantuar cilësinë e kontratës, veçanërisht kur sistemi i gazit mjekësor përbën vetëm një pjesë të punimeve,

Po te ndalemi ne nenin Neni 87 te ligjit te Prokurimit Publik, ky I fundit citon:

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

- a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;
 - b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose
 - c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.
- Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.
3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:
- a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose
 - b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.
4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.
5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.
- Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.

Rikonstruksioni i një spitali është një projekt kompleks, i cili përfshin shumë komponentë ndërtimi, instalimesh, rifiniturash dhe teknologjie. Instalimi i gazit mjekësor përbën vetëm një pjesë të vogël të këtij projekti dhe nuk është thelbësor në të gjitha llojet e strukturave spitalore ndaj vendosja e një kriteri me peshë të konsiderueshme (15 pikë nga 100) vetëm për këtë element teknik nuk është në përputhje me objektin real dhe të përgjithshëm të kontratës, i cili ka për qëllim rikonstruksionin e të gjithë spitalit dhe rrjedhimisht bie ndesh me paragrafin 3, i cili kërkon që kriteret të lidhen me punimet apo shërbimet “në çdo drejtim dhe çdo fazë të ciklit jetësor të kontratës”.

Ky kriter e shkëput vëmendjen nga cilësia e përgjithshme e punimeve dhe fokuson vlerësimin vetëm në një zë të izoluar i cili e ka ‘jetëgjatesinë’ vetëm në një fazë të shkurter të projektit.

Sipas paragrafit 2, kriteret cilësore lejohen, por vetëm kur kanë një ndikim domethënës në zbatimin e kontratës. Përvoja në instalimin e gazit mjekësor është e rëndësishme, por:

? Ajo mund të sigurohet edhe nëpërmjet nënkontraktorëve të specializuar, dhe nuk është kriter përcaktues për suksesin e gjithë projektit.

? Rëndësia e saj nuk justifikon 15% të totalit të pikëve, duke cenuar parimin e proporcionalitetit dhe duke nxitur një vlerësim të padrejtë.

Më tej, sipas paragrafit 4, çdo kriter duhet të mos japë liri të pakufizuar autoritetit kontraktor për të favorizuar ofrues të caktuar, dhe të lejojë konkurrencë efektive.

Në këtë rast, vendosja e një kriteri që praktikisht mund të plotësohet nga shumë pak operatorë në treg, që kanë historik në projekte të ngjashme, është një barrierë artificiale, që çënon drejtpërdrejt lirinë e garës dhe ul interesin e operatorëve potencialë.

Po të bëjme një analizë teknike, në kuadër të një kontrate rikonstruksioni të ambienteve spitalore apo shëndetësore, firma jonë mbulon një sërë punimesh të lidhura ngushtë me instalimin e sistemeve të gazrave mjekësore, duke përfshirë përgatitjen e infrastrukturës ndërtimore dhe mbështetëse për vendosjen e këtyre sistemeve. Konkretisht, ne realizojmë hapjen e kanaleve në mure apo dysheme për vendosjen e tubacioneve, ndërhyrje në struktura për të mundësuar kalimin e rrjeteve, si dhe montimin e strukturave mbajtëse ose mbrojtëse që shërbejnë për instalimin e pajisjeve dhe paneleve për gazra mjekësorë. Gjithashtu, sigurojmë ndërhyrjet e nevojshme në sistemet elektrike dhe konstruktive, për të krijuar vendin teknik të nevojshëm për vendosjen e pajisjeve sipas kërkesave të projektit dhe prodhuesit. Pas montimit të sistemeve, realizojmë punimet e rifiniturës për rikthimin e ambienteve në gjendjen përfundimtare (suva, lyerje, veshje etj.), në përputhje me standardet e kërkuara në objektet shëndetësore.

Është me rëndësi të theksohet se pjesa e instalimit dhe vënies në punë të pajisjeve specifike për gazra mjekësorë, si dhe kryerja e testeve teknike dhe dorëzimi me dokumentacion certifikues, bëhet domosdoshmërisht nga teknikë të autorizuar nga vetë prodhuesi i pajisjes, sipas rregullave të sigurisë dhe direktivave europiane për pajisje mjekësore. Kjo është një praktikë e standardizuar që nuk përfshihet në fushën e veprimtarisë së një firme ndërtimi, por realizohet nga personel i specializuar, shpesh i ardhur bashkë me furnizimin e pajisjes nga prodhuesi i licencuar.

Për rrjedhojë, kërkesa për të pasur eksperiencë direkte në instalimin dhe vënien në punë të gazrave mjekësorë nuk është e përshtatshme për një firmë ndërtimi që mbulon vetëm pjesën ndërtimore dhe përgatitore të projektit. Ne mbështesim realizimin e kësaj pjese me kapacitete reale dhe të dokumentueshme, të cilat janë në përputhje me objektin dhe natyrën e kontratës së rikonstruksionit, ndërkohë që pjesa e pajisjes mbulohet sipas praktikave të zakonshme përmes bashkëpunimit me operatorë të autorizuar ose përmes furnizuesit të pajisjeve.

Në analizën me sipër jemi ndalur te fakti që pjesa e sistemit të gazit mjekësor mund të sigurohet nëpërmjet subjekteve të specializuara, dhe nuk është kriter përcaktues për suksesin e gjithë projektit madje vete Autoriteti Kontraktor e ka kërkuar këtë të fundit me kriterin e poshtecituar:

2.3.7 Deklaratë e ofruesit për modelin, kompaninë prodhuese, për mallrat e pajisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i pajisjes/materialeve	Modeli	Kompania prodhuese,	Web,	E-mail,	Nr. kontakti
6	Fv.pajisjet mjekësore (oksigen,vakum,ajer) me panel bllok vertikal i kompletuar,mekanaline per perdorim ne ambiente spitalore per trajtim pacientit e montuar ne mur					

2.3.7/a Për pajisjet/materialet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.7, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/materiale. Në rast paraqitje autorizim distributori autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore të kërkuara.

Në dokumentet e tenderit është parashikuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin marrëveshje autorizimi nga një subjekt prodhues ose distributor për furnizimin dhe vendosjen e pajisjeve mjekësore që janë pjesë integrale e sistemit të gazit mjekësor (panele murale të kompletuara, kanalinë, pajisje për oksigen, ajër dhe vakum etj.).

Kjo kërkesë, në vetvete, është legjitime dhe logjike, pasi synon të sigurojë që furnizimi i pajisjeve të ndjeshme të bëhet nga prodhues të certifikuar dhe me përvojë në këtë fushë të specializuar.

Megjithatë, në kontrast me këtë kërkesë, autoriteti vendos si kriter vlerësimi edhe përvojën e mëparshme të vetë operatorit në sisteme të gazit mjekësor, duke mos pranuar faktin që montimi dhe garancia teknike në këtë rast mbështetet tek kompania e autorizuar/prodhuesi i specializuar. Kjo bie ndesh me parimin e bashkëpunimit teknik dhe industrial, i cili është i zakonshëm dhe i ligjshëm në kontratat publike që përfshijnë pajisje të specializuara.

Praktika ndërkombëtare dhe legjislacioni i BE-së njohin të drejtën e operatorëve për të përdorur kapacitetet teknike dhe profesionale të një subjekti tjetër, përmes marrëveshjeve ose kontratave të nënshkruara me furnizues ose nënkontraktorë (referuar nenit 63 të Direktivës 2014/24/BE).

Në këtë rast, duke parashikuar domosdoshmërisht përvojë vetjake të operatorit në sistemin e gazit mjekësor, edhe kur ai paraqet një autorizim nga prodhuesi/distributori i certifikuar, autoriteti nuk njeh vlerën e marrëveshjes së autorizimit, duke e reduktuar atë në një formalitet pa ndikim real.

Kjo cenon parimin e proporcionalitetit, sepse:

- ? Ofruesi i autorizuar është ai që garanton cilësinë dhe montimin e pajisjeve;
- ? Operatorët që nuk kanë realizuar më parë vetë një sistem të tillë por kanë mbështetje nga një kompani lider në këtë fushë, përjashtohen padrejtësisht nga gara.

Kjo sjell ngushtim të panevojshëm të konkurrencës dhe rrezik të lartë që pjesëmarrja në tender të kufizohet vetëm në disa operatorë të caktuar, që kanë pasur mundësi më parë të realizojnë punime të tilla specifike.

Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej ketyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues.

Per sa i perket Zbatimit te elementit të natyrës së ngjashme theksojme qe si referencë për përvojë të ngjashme nje object duhet te përmbaj komponentë teknike dhe zera që janë thelbësisht të krahasueshme me objektin e tenderit, duke përfshirë elemente që plotësojnë funksionalitetin.

Praktikat e miratuara nga Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) theksojnë që kontratat e ngjashme duhet të vlerësohen për ngjashmërinë e përgjithshme dhe jo për përputhjen e saktë në çdo detaj Teknik mbi te gjitha kur ato zera qe pretendohet mosperputhje zen nje perqindje jo te konsiderueshme te te gjithë preventivit. Per kete rast permendim dhe vendimin e Komisionit te prokurimit public Nr 256/2 date 19.02.2025.

Sipas praktikës së prokurimit dhe kuadrit ligjor në fuqi, përvoja e mëparshme (si kriter kualifikimi teknik) duhet të lidhet me objektin e kontratës së shpallur dhe jo me çdo zë individual të preventivit. Në rastin konkret, objekti i kontratës është i përcaktuar si ‘rikonstruksion’ i një ndërtese spitalore, çka do të thotë se përvoja e kërkuar duhet të jetë gjithashtu në fushën e rikonstruksionit.

Nuk është e justifikuar dhe as e lejuar që për çdo artikull të preventivit të vendosen kritere të veçanta eksperience, sidomos kur kemi të bëjmë me artikuj të natyrës së ‘furnizim dhe vendosje’ dhe jo të ndërtimit. Praktika të tilla jo vetëm e bëjnë kriterin të tepruar, por e kthejnë në një pengesë

artificiale për garuesit e ligjshëm, duke cenuar parimin e konkurrencës së lirë dhe proporcionalitetit.

Kriteret e kualifikimit nuk mund të ndërtohen sipas çdo zëri të preventivit, për sa kohë që ky i fundit përfshin një sërë artikujsh që nuk kanë karakter ndërtimor dhe që nuk përbëjnë objekt të kontratës në vetvete. Për këtë arsye, kërkesa për të paraqitur ‘punë të ngjashme’ për artikullin ‘furnizim dhe vendosje panel oksigjeni, vakum, ajër’ është e pambështetur teknikisht dhe juridikisht, pasi nuk përbën punë ndërtimore dhe nuk është në përputhje me objektin e kontratës.

Për sa me sipër, kërkojme heqjen e këtij kriteri që lidhet me pikëzimin mbështetur në eksperiencën e ngjashme në sistemin e gazit mjekësor.

? Ne Dokumentat Standarte të Tenderit, në pikën 2.3.14 Autoriteti kontraktor ka kërkuar:

Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij ose staf mbështetës 1 (një) Inxhinier i pajisur me Diplomë/ certifikate për Menaxhim Projektesh, në lidhje me këtë inxhinier të paraqitet edhe diploma/certifikata/ një dokument që verteton se punonjesi është i certifikuar për menaxhimin e projekteve.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

? Diplomë/certifikatë

? Kontratë Punë të vlefshme

Duke e mbështetur në argumentimin:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

-Inxhinieri Menaxhim Projektesh është përgjegjës për planifikimin, organizimin, dhe mbikëqyrjen e projektit nga fillimi deri në fund. Ky rol kërkon një kombinim të aftësive teknike dhe aftësive menaxheriale për të siguruar që projekti të përfundojë me sukses brenda afateve të përcaktuara dhe buxhetit të planifikuar.

Për sa me sipër gjykojmë se duke u nisur nga fakti që objekti i tenderit është rikonstruksion ose punime të zakonshme ndërtimi (dhe jo një projekt me kompleksitet të lartë ndërdisiplinor apo bashkëfinancim shumëpalësh), nuk ka një bazë teknike dhe ligjore që të justifikojë domosdoshmërinë e një personeli të certifikuar posaçërisht për menaxhim projektesh.

Ky kriter tejkalon kërkesat ligjore për kualifikim teknik pasi sipas legjislacionit për prokurimet publike, kërkesat për kapacitete teknike dhe profesionale duhet të jenë:

? të lidhura me objektin e kontratës

? proporcionale me kompleksitetin e saj

? jo më kufizuese se sa është objektivisht e nevojshme

Vendosja e një kërkesë të tillë për një certifikatë të veçantë, pa një arsyetim teknik në dokumentet e tenderit përbën cenim të parimeve themelore të prokurimit.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor në argumentimin e këtij kriteri është shprehur se “me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Inxhinieri Menaxhim Projektesh është përgjegjës për planifikimin, organizimin, dhe mbikëqyrjen e projektit nga fillimi deri në fund” atëherë dhe një inxhinier i ndërtimit me përvojë shumëvjeçare në drejtimin teknik të punimeve dhe menaxhimin e zbatimit praktik të kontratës, është më se i aftë të përmbushë përgjegjësitë që kërkon kjo kontratë, dhe nuk ka asnjë nevojë shtesë për një certifikim të veçantë.

Permendim ketu ligjin nr. 3/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar
“Neni 3 Përkufizime Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

12. “Drejtnes teknik” është personi fizik, i përcaktuar në licencën e shoqërisë, i cili është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standardet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

Ligji dhe aktet ligjore ne territorin e Shqiperise nuk kërkojnë certifikatë të veçantë për “menaxhim projektesh” si kusht për drejtimin e nje projekti, përveç diplomës universitare në fushë përkatëse dhe përvojës profesionale të provuar.

Prandaj, vendosja e një kërkesë shtesë, për një certifikatë të veçantë për menaxhim projektesh (që nuk përmendet në asnjë akt ligjor apo nënligjor), është e pajustificuar, disproporcionale dhe pengon operatorët pa arsye reale.

Funksioni i menaxhimit të projektit në fushen e ndërtimit është pjesë integrale e detyrave të drejtuesit teknik, sipas ligjit shqiptar.

Kërkesa për një individ tjetër me titull “menaxher projekti” dhe me certifikatë të veçantë duplikon detyrat, krijon barrë të panevojshme dhe shkel parimin e proporcionalitetit

Prandaj, kërkesa duhet të rishikohet ose të hiqet nga dokumentacioni i tenderit.

Për sa më sipër kërkojmë ndryshimin e dokumentave standarte të tenderit për arsyet e cituara.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme ☐

Po ☐

Jo ☒

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

JO

7. Lista e informacionit konfidencial: ☐

JO

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes. ☐

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

inerti.shpk@gmail.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Florjan Muha